



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretariati Koordinues i Qeverisë
Koordinacioni Sekretariat Vlade - Government Coordination Secretariat

DRAFT

Koncept dokument për politikën:

“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”

Prishtinë, prill 2019

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit	3
Hyrje	7
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	8
Kapitulli 2: Objektivat.....	46
Kapitulli 3: Opsionet.....	47
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim.....	48
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit	48
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument].....	48
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	48
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	51
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	53
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	58
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	59
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tri opsionet	56
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	63
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	66
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	67
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqëror	70
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore.....	73
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin në të drejtat themelore	76

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”
Ministria bartëse	Zyra e Kryeministrit - Sekretariati Koordinues i Qeverisë
Personi kontaktues	Arben KRASNIQI, Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë/Udhëheqës i Ekspertit Arife GASHI, Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave Sekretariati Koordinues i Qeverisë Tel: 038 200 14 105 E-mail: arife.gashi@rks-gov.net
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2019, Tabela B, Objektivi 1, Aktiviteti 10, Treguesi 1 Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019, e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit bazuar në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (15.01.2019-Ref.10/2019)
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Zyra e Kryeministrit, Objektivi 2, “Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës”

Vendimi	
Çështja kryesore	<p>Mospërfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës institucionale të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë mungesa e një zgjidhjeje e cila do t’ua mundësonte shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, gjegjësisht Universiteti i Mitrovicës së Veriut, institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, të aplikojnë për punësim dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje tjera për të cilat është e nevojshme paraqet problemin kryesor në këtë çështje. Kjo e vështirëson zbatimin e parimeve të cilat janë të garantuara me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht parimin e trajtimit të barabartë, parimin e të drejtave për arsimim e punësim dhe parimin e mosdiskriminimit.</p> <p>Rregullimi i çështjes së arsimit në gjuhën serbe në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare si dhe propozimi i një zgjidhjeje që do t’ua mundësojë shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe për të aplikuar për punësim dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje tjera për të cilat është e nevojshme për integrim social.</p>
Përmbledhje e konsultimeve	Përmes takimeve të ndryshme janë zhvilluar konsultimet me ekspertë dhe njohës të kësaj fushe, si dhe përfaqësues të komunave dhe institucioneve qendrore, të cilët kanë shprehur pikëpamjet e tyre për nevojën e rregullimit të kësaj fushe.

	<p>Me qëllim të prezantimit të draftit të koncept dokumentit, në fund të muajit shtator 2018 është organizuar një punëtori, ku pjesëmarrës ishin anëtarët e Ekipit dhe përfaqësues nga institucionet përkatëse. Gjatë kësaj punëtorie, të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan me dokumentin e prezantuar, si dhe pati disa propozime të reja, të cilat janë adresuar në dokument.</p> <p>Zyra e Kryeministrit, duke u bazuar në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, konkretisht nenin 7, nga data 21.02.2019 deri më datë 13.03.2019 ka përcjellë draft koncept dokumentin për konsultime paraprake tek të gjithë akterët përkatës, për dhënien e opinioneve.</p> <p>Pas konsultimeve paraprake është mbajtur punëtorja e dytë e Ekipit nga 13 deri më 17 mars 2019. Në këtë punëtori janë shqyrtuar komentet dhe sugjerimet gjatë konsultimeve paraprake si dhe janë marrë parasysh komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve në punëtori.</p> <p>Koncept dokumenti është publikuar në platformën online të konsultimeve nga data 20 mars deri më datë 10 prill 2019. Komente janë pranuar nga OSBE-ja dhe Komisioni për Verifikimin e Diplomave, të cilat janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar në versionin final të koncept dokumentit.</p> <p>Gjithashtu, me plan të komunikimit janë paraparë aktivitetet që do t’i ndërmarrim edhe pas procesit të konsultimeve publike dhe miratimit të koncept dokumentit.</p>
Opsioni i propozuar	<p>Për zgjidhjen e çështjes janë tri opsione:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Opsioni i status quo-së; 2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit; dhe 3. Opsioni i tretë për zgjidhjen e gjendjes. <p>Opsioni i parë, gjegjësisht opsioni pa ndryshime, i njohur edhe si opsioni i status quo-së, si dhe opsioni i dytë, pengojnë punësimin e personave të diplomuar në institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.</p> <p>Si opsion më i favorshëm për rekomandim, duke marrë parasysh rrethanat dhe proceset aktuale, konsiderohet të jetë opsioni i tretë. Ky opsion synon plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhet përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave, jo vetëm për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, por edhe për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare.</p> <p>Lëshimi i certifikatave të vlefshmërisë dhe përdorimi i tyre si zëvendësim i diplomave të lëshuara nga institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe do të ishte masë e përkohshme afirmative për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit</p>

	<p>publik dhe për integrim social.</p> <p>Në ndërlidhje me këtë rekomandohet të bëhet gjithashtu hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, si opsion i tretë i pasqyruar në këtë koncept dokument. Zbatimi i këtij opsioni bëhet me një gjithëpërfshirje të akterëve, që do t’i ndihmonte edhe politikëbërësit në gjetjen e një zgjidhjeje kushtetuese dhe ligjore, por që ka edhe implikime politike.</p>
--	---

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor.
Ndikimet ekonomike	Do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik. Do të rritet numri aktual i vendeve të punës.
Ndikimet shoqërore	Do të ketë rritje të mundësisë së punësimit, e cila do të ndikojë në rritjen e mirëqenies sociale. Do të ndikojë në zbatimin e parimeve të trajtimit të barabartë të individit në shoqëri.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndërsektoriale	Do të ketë koordinim dhe bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional, gjë që do të ndikojë në krijimin dhe forcimin e mekanizmave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk vlen.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hap afatshkurtër është Opsioni nr. 2: plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhej përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.
Afatmesëm	Hap i ardhshëm afatmesëm është hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës. Me këtë strategji duhet të parashihen veprime dhe masa konkrete në gjetjen e një zgjidhjeje kushtetuese dhe ligjore për mësimin në gjuhën serbe, gjithmonë duke pasur parasysh një qasje të barabartë të të gjitha komuniteteve. Këtë hap institucionet e Republikës së Kosovës mund ta ndërmarrin krahas zbatimit të hapit afatshkurtër por me një gjithëpërfshirje të akterëve përkatës si dhe me një proces të konsultimeve publike,

Koncept Dokumenti: *“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”*

	që do t'i ndihmonte edhe politikëbërësit në gjetjen e një zgjidhjeje kushtetuese dhe ligjore.
--	---

Hyrje

Figura1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”
Ministria bartëse	Zyra e Kryeministrit - Sekretariati Koordinues i Qeverisë
Personi kontaktues	Arife GASHI, Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave Sekretariati Koordinues i Qeverisë Tel: 038 200 14 105 E-mail: arife.gashi@rks-gov.net
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2019, Tabela B, Objektivi 1, Aktiviteti 10, Treguesi 1 Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019, e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit bazuar në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (15.01.2019-Ref.10/2019)
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Zyra e Kryeministrit, Objektivi 2, “Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës”
Ekipi	Ekipi përgjegjës për hartimin e koncept dokumentit, i themeluar me Vendimin e Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit - nr. ref.: 251/2018, 16.08.2018, ka punuar në këtë përbërje: <ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqës i Ekipit - Sekretariati Koordinues i Qeverisë; • Zëvendësudhëheqës i Ekipit - Sekretariati Koordinues i Qeverisë • Kabineti i Kryeministrit, anëtar • Zyra Ligjore - Zyra e Kryeministrit, anëtar • Zyra për Çështje të Komuniteteve - Zyra e Kryeministrit, anëtar • Departamenti për Integrim Evropian - ZKM, anëtar • Zyra për Buxhet dhe Financa - ZKM, anëtar • Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare - Zyra e Presidentit, anëtar • Këshilli Konsultativ për Komunitete - Zyra e Presidentit, anëtar • Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar • Ministria për Komunitete dhe Kthim, anëtar • Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar • Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar • Ministria e Administratës Publike, anëtar • Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve - ECMI Kosova, anëtar • Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut,
Informata shtesë	Nuk ka

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Koncept dokumenti: *“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”* (në tekstin e mëtejshëm: koncept dokumenti) është hartuar nga Ekipi përgjegjës për hartimin e koncept dokumentit, i themeluar me Vendimin e Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit - nr. ref.: 251/2018, 16.08.2018 (në tekstin e mëtejshëm: Ekipi). Ekipi ka pasur përkrahjen e vazhdueshme nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova)¹ dhe bashkëpunimin me Komisionin për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.²

Gjatë hartimit dhe finalizimit të këtij koncept dokumenti, Ekipi iu ka përmbajtur rregullave dhe procedurave të përcaktuara të Qeverisë, Udhëzuesit dhe Doracakut për hartimin e koncept dokumenteve nr. 20/20 të datës 20/12/2017, si dhe ka marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe një numër dokumentesh të Qeverisë.³ Ekipi gjithashtu ka shqyrtuar dhe analizuar Raportin e ECMI Kosova: Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, dhe ka përfshirë sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna nga palët e interesuara gjatë një numri punëtorish, tryezash të rumbullakëta dhe konsultimesh publike.

Gjatë hartimit dhe finalizimit të koncept dokumentit, Ekipi ka bërë një analizë të përgjithshme të gjendjes së arsimit në gjuhën serbe në Republikën e Kosovës. Kjo është bërë me qëllim që ky koncept dokument të shërbejë edhe si dokument për strategjinë afatgjate të Republikës së Kosovës për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës institucionale të Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë e kësaj, synohet të propozohet një zgjidhje e cila do t’ua mundësojë shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe që të aplikojnë për punësim, për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje tjera për të cilat është e nevojshme.

1. ECMI Kosova është e autorizuar nga Qeveria me Vendimin nr. 11/81 të datës 23.03.2016 për mbështetjen e punës së Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, dhe në pajtim me pikën 3 të Vendimit të Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit - nr. ref.: 251/2018, 16.08.2018, ka ndihmuar dhe përkrahur Ekopin në hartimin dhe finalizimin e koncept dokumentit.

² Në pajtim me Rregulloren (QRK) - nr. 21/2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2016, ka nxjerrë Vendimin nr. 08/73 të datës 05.02.2016 për themelimin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.

³ Shih koncept dokumentin e miratuar në mbledhjen e 22-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 04/22 të datës 3 prill 2015 dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Zyra e Kryeministrit, Objektivi 2, “Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës”.

Universiteti i Mitrovicës së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: UMV) dhe institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe kryesisht nuk veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Praktika e arsimit paralel në gjuhën serbe në Kosovë daton që nga periudha e pasluftës në Kosovë (1999) dhe vendosjes së administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Rrjeti arsimor në gjuhën serbe është reduktuar në statusin e rrjetit paralel, jashtë kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, dhe përkrahet nga Serbia.

Që nga përfundimi i luftës (qershor 1999) e deri më sot, rrjeti arsimor në gjuhën serbe kryesisht nuk bashkëpunon me institucionet e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht përdor një sistem tjetër nga ai që përdorin institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Serbisë investon në arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë nëpërmjet të ashtuquajturës “Zyrës për Kosovë dhe Metohi” apo Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Po ashtu, shkollat në gjuhën serbe kanë marrë mbështetje dhe donacione edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe autoritetet komunale të Republikës së Kosovës.

Shkollat në gjuhën serbe, ndonëse nuk njihen nga Republika e Kosovës, gjegjësisht nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), përfitojnë nga mbështetja nga ana e komunave me shumicë serbe që veprojnë brenda sistemit kosovar. Në të vërtetë, shkollat në komunën e Mitrovicës së Veriut kanë përfitur përkrahje financiare me mjete të ndara nga MASHT dhe të shpërndara nga Komuna në shumë prej gjithsej rreth 1.564.600 eurosh brenda një periudhe prej tri vjetësh (2015/2016/2017).⁴

Siç shihet edhe në Raportin e ECMI-Kosova (Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë), të dhënat e mbledhura janë heterogjene dhe zbulojnë shumëllojshmëri të konsiderueshme kur krahasojmë katër komunat në veriun e Kosovës me zonat me shumicë serbe të shpërndara në pjesën tjetër të Kosovës. Mund të vihet re se shkollat në katër komunat veriore kanë kushte më të mira pune dhe pajisje më të mira sesa shkollat në pjesën tjetër të Kosovës. Në këtë vlerësim theksohen shqetësimet serioze në lidhje me mangësitë infrastrukturore dhe mungesën e hapësirës. Në pjesën jugore të vendit shkollat janë të vendosura në ndërtesa që nuk janë të destinuara për këtë qëllim.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në vitin 2015, ka miratuar⁵ Koncept Dokumentin: Procedurat e aplikimit për vende pune në institucionet e Republikës së Kosovës për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe si rrjedhojë e saj është miratuar *Rregullorja (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë*

⁴ Shih f. 25, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë, 2018.

⁵ Shih Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/22, i datës 3 prill 2015

*diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike.*⁶

Qëllimi i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut (UMV). Duke u bazuar në këtë rregullore, lëshimi i certifikatave dhe përdorimi i tyre si zëvendësim i diplomave të UVM-së është masë e përkohshme afirmative për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit publik.⁷

Në pajtim me Rregulloren (QRK) - nr. 21/2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2016, ka nxjerrë Vendimin nr. 08/73 të datës 05.02.2016 për themelimin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut (Komisioni), si hap i tretë drejtë realizimit të qëllimit për të siguruar barazinë e plotë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.⁸


Duke u bazuar në raportin e tremujorit të dymbëdhjetë (nëntor, dhjetor 2018 dhe janar 2019) të Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, që nga koha kur Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut ka filluar punën (12 maj 2016), gjendja deri me datë 31.01.2019 është si në vijim:

- Aplikacione të pranuar - 1582;
- Aplikacione të verifikuara pozitive - 1451;
- Aplikacione të verifikuara negative - 38;
- Aplikacione të pakompletuara - 3;
- Aplikacione në proces të shqyrtimit - 90.

⁶ Rregullorja (QRK) - nr. 21/2015 është miratuar në mbledhjen e 67-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 03/67 të datës 30.12.2015. Neni 5 i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 është ndryshuar në mbledhjen e 73-të të Qeverisë me Vendimin nr. 12/73 (05.02.2016), ndërsa neni 2.3 i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 është ndryshuar në mbledhjen e 144-t të Qeverisë me vendimin nr. 05/144 (04.05.2017). Po ashtu, kjo rregullore është ndryshuar edhe me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/45 (08.05.2018) për vazhdimin e mandatit të punës edhe për një vit të Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, ndërsa me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/45 (08.05.2018) është bërë vazhdimi i mandatit të punës së Komisionit edhe për një vit.

⁷ Shih nenin 1 të Rregullores (QRK) - nr. 21/2015.

⁸ Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut përbëhet prej katër (4) anëtarëve. Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/45 (08.05.2018) është bërë vazhdimi i mandatit të punës edhe për një vit të Komisionit si dhe janë zëvendësuar dy anëtar që kanë dhënë dorëheqje.



Duke marrë parasysh rezultatet e treguara me punën e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe interesimin e shprehur të qytetarëve të Republikës së Kosovës që kanë përfunduar studimet në këtë universitet, si dhe duke marrë për bazë kërkesat që të zgjerohet mandati i Komisionit dhe në këtë proces të verifikimit të përfshihen përveç Universitetit të Mitrovicës së Veriut edhe institucionet tjera arsimore në Republikën e Kosovës në të cilat zhvillohet mësimi gjuhën serbe, veçanërisht shkollat e larta, kolegjet, shkollat profesionale dhe shkollat e mesme, në këtë drejtim është parë e nevojshme që të bëhet një analizë e thuktë për avancimin e këtij procesi, gjithnjë duke marrë parasysh përkushtimin e Republikës së Kosovës për të zbatuar Kushtetutën dhe legjislacionin e saj në tërë territorin e vet dhe për të siguruar barazinë e plotë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Në këtë drejtim, edhe hartimi i këtij koncept dokumenti është vazhdimësi e punës dhe proceseve që ka ndër marrë Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2015.

Derisa qëllimi i koncept dokumentit të miratuar në vitin 2015 dhe i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike ishte që të propozojë një zgjidhje që do t'ua mundësojë shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga UMV që të aplikojnë për punësim në institucionet publike të Republikës së Kosovës, qëllimi i këtij koncept dokumenti është që të avancojë dhe zgjerojë këtë proces, duke mundësuar zgjerimin e mandatit të Komisionit dhe përfshirjen e të gjitha institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.

Pra, qëllimi i këtij koncept dokumentit është që të propozojë një zgjidhje për rregullimin e çështjes së arsimit në gjuhën serbe që do t'ua mundësojë shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe që të aplikojnë për punësim dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje tjera për të cilat është e nevojshme për integrim social.

Koncept dokumenti ka për qëllim të shqyrtojë gjendjen e përgjithshme të institucioneve në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe. Gjithashtu, synohet që çështja e aplikimit për vende pune dhe marrja e licencave dhe provimeve profesionale nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe të zbatohet nga prizmi i të drejtës për arsimim dhe të drejtës për punë, ku që të dyja janë të drejta dhe liri themelore të mbrojtura dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky koncept dokument, para së gjithash, merr parasysh përkushtimin e Republikës së Kosovës për të zbatuar Kushtetutën dhe legjislacionin e saj në tërë territorin e vet dhe për të siguruar barazinë e plotë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Neni 3 (Barazia para Ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), përcakton:

- 1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
- 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.⁹*

Kushtetuta u jep pjesëtarëve të komuniteteve të drejtën që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.¹⁰ Çdoherë duhet pasur parasysh faktin se: ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.¹¹

Në mënyrë më të veçantë, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitete: (1) të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre; (2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre; (. . .) (4) të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.¹²

⁹Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3.

¹⁰Po aty, neni 57(3).

¹¹Po aty, neni 57(4).

¹²Po aty, neni 59(1,2,4)

Republika e Kosovës siguron kushte të duhura, të cilat ua mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.

Korniza ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës për arsimin në gjuhën serbe

Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike, që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve.¹³

Për me tepër, Kushtetuta përcakton përgjegjësitë e Shtetit, që: “sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.”¹⁴ Kjo dispozitë shtjellohet më tej edhe në legjislacionin pasues: *Republika e Kosovës ndërmerri masat e veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi.*¹⁵

Republika e Kosovës ka krijuar një kornizë ligjore të avancuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve. Në këtë drejtim, arsimi në gjuhën serbe zë një pozitë të shquar dhe i jepet një trajtim i veçantë.

Ligji për Arsimin e Lartë përcakton kornizën kryesore për funksionimin e institucioneve publike të arsimit të lartë, duke përfshirë universitetet.¹⁶ Arsimi i lartë mund të ofrohet nga çdo bartës i licencuar i arsimit të lartë, pa kufizim sa i përket kohëzgjatjes apo strukturës së vitit shkollor, me kusht që të mund t’ia dëshmojë në mënyrë të kënaqshme një organi akreditues se diplomat e tij plotësojnë standardet e pritshme për diploma të tilla brenda Zonës evropiane të

¹³ Ligji nr. 03/047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1(1) (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr. 28, 4 qershor 2008).

¹⁴ Shih Po aty, neni 58, paragrafi 4 i riformuluar me Amendamentin 1.

¹⁵ Ligji nr. 03/047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1(2) (*Gazeta Zyrtare*, nr. 28, 4 qershor 2008).

¹⁶ Ligji nr. 04 / L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 10 (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr.14, 09 shtator 2011) përkufizon një universitet si “një institucion arsimor dhe kërkimor që ofron diploma dhe grada akademike, përfshirë në nivel doktorature, për qëllim të: (a) përparimit në fushën e njohurive akademike, në Kosovë, në rajon dhe më gjerë; (b) zhvillimit arsimor, shkencor, artistik, kulturor, social dhe ekonomik të Kosovës, zhvillimit të shkathëtisë aftësive profesionale dhe kompetencave të larta; dhe (c) promovimit të qytetarisë demokratike dhe arritjes së standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe të nxënimit.” Ai përcakton se termi ‘universitet’ mund t’i jepet vetëm një bartësi të akredituar të arsimit të lartë i cili është duke ofruar kurse apo programe të akredituara për së paku pesë vjet, në të paktën pesë fusha të studimit, siç është paraparë me rregulloret e Ministrisë, dhe i cili i ka dhënë të paktën një gradë të doktoraturës në cilindo nga këto programe studimi.”

arsimit të lartë.¹⁷ Megjithatë, bartësit publikë të arsimit të lartë mund të themelohen vetëm me vendim të Ministrit, i cili duhet të ratifikohet nga Kuvendi. Për më tepër, themelimi i një bartësi publik të arsimit të lartë duhet të shoqërohet me dhënien e një licence.¹⁸

Shembull i mirë i trajtimit të veçantë të arsimit në gjuhën serbe është Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës¹⁹, ku në nenin 8 përcaktohet si në vijim:

8.1 Të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. Qeveria vendos pragjet e arsyeshme dhe të zbatueshme për themelimin e klasave apo shkollave të veçanta që funksionojnë në gjuhët e komuniteteve. Pragu minimal për klasa apo shkolla të tilla është më i ulët se pragjet e vendosura normalisht për institucionet dhe klasat shkollore. Pragjet maksimale do të korrespondojë me pragjet e vendosura normalisht për klasat shkollore. Kjo rregullohet me ligj.

8.2 Në komunat në të cilat, ka një numër të pamjaftueshëm nxënësish për të vënë në dispozicion shkollimin në një gjuhë jo-zyrtare të komunitetit, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka për detyrim të ofrojë alternativa, duke përfshirë transportin e subvencionuar deri në zonat ku ofrohet shkollim i tillë, shkollimin në distancë, aranzhimet e ndryshme për mësimdhënie të lëvizshme, apo edhe ofertat për qëndrim në konvikt.

8.3 Republika e Kosovës garanton mundësitë ekzistuese për trajnim profesional dhe shkollim të lartë në nivel universitar, në gjuhët e komuniteteve. Në pajtim me nevojën e shprehur dhe mundësitë financiare, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ofrojë shkollim të mëtutjeshëm të lartë dhe programe të trajnimit profesional në gjuhët e komuniteteve.

8.4 Komunitetet dhe pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të themelojnë dhe menaxhojnë institucionet e tyre private për shkollim dhe trajnim, për të cilat mund të ofrohet ndihmë financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Institucionet e tilla kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nëse janë në përputhje me standardet e përgjithshme arsimore të plan programeve të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë monitoron cilësinë e mësimdhënies në pajtim me ligjin.

¹⁷ Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 5(7) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14, 09 shtator 2011).

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare / nr. 28 / 04 qershor 2008), Ligji nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 25 / 07 shtator 2012) (neni 15 Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës) dhe Ligji nr. 04/L-020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 29 / 27 dhjetor 2011).

8.5 Shkollat që japin mësim në gjuhën serbe mund të aplikojnë plan-programe apo tekste mësimore të përgatitura nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë Kosovare të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me procedurat e vendosura në Ligjin për Arsimin Lokal.

8.6 Universiteti i Mitrovicës Veriore është një institucion autonom publik i shkollimit të lartë. Komuna e Mitrovicës Veriore ka autoritet të ushtrojë përgjegjësi për këtë universitet në gjuhën serbe siç rregullohet me ligj.

8.7 Për të gjitha rastet përveç atyre të përmendura në paragrafin 5 të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës harton plan-programe të integruara në gjuhët e komuniteteve të cilat nuk janë gjuhë zyrtare si dhe standardet arsimore për të gjitha aspektet e shkollimit dhe monitoron dhe përforcon cilësinë e mësimdhënies në gjuhët e komuniteteve. Institucionet shkollore që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në gjuhën e një komuniteti që nuk është gjuhë zyrtare, mund të t'i dizajnojnë plan-programet shkollore të tyre në mënyrën e tyre, me kusht që ato të jenë në përputhje me kornizën e përgjithshme të plan-programit të integruar dhe që t'i përmbushin standardet e arritjes që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për më tepër, komunitetet kanë të drejtë që në bashkëpunim me Qeverinë, të përgatisin module shkollore që kanë të bëjnë me kulturën, historinë dhe traditat e tyre.

8.8 Qeveria e Republikës së Kosovës në përgatitjet e saj për trajnimin e mësuesve, siguron që të ketë kuadër të mjaftueshëm për t'i përmbushur obligimet e cekura në paragrafin 6 të këtij neni. Trajnimi i mësuesve për ata që kërkojnë të japin mësim në gjuhët e komuniteteve zhvillohen në gjuhët përkatëse. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve të përshtatshëm, autoritetet duhet të kenë parasysh nevojën që mësimdhënia në gjuhët e komuniteteve të ofrohet nga folësit e kualifikuar të gjuhës së dhënë, ku parapëlqehen folësit burimor.

8.9 Qeveria e Republikës së Kosovës siguron që drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve të shkollimit publik që aktivitetin e tyre e zhvillojnë në gjuhët e komuniteteve janë kryesisht përfaqësues të këtyre komuniteteve dhe njohin në tërësi identitetin e komunitetit përkatës.

8.10 Në shkollat fillore dhe të mesme në të cilat gjuha e mësimi nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit do të mësojnë një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes së tyre në pajtim me ligjin.

8.11 Qeveria e Republikës së Kosovës siguron qasje të barabartë të personave që iu përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Në këtë drejtim, Qeveria krijon masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar.

8.12. Plan-programi shkollor kombëtar i Kosovës mbulon historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në vend, me qëllim që të nxis frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës midis të gjitha komuniteteve në Kosovë. Organizatat përfaqësuese të komuniteteve do të konsultohen gjatë hartimit të plan-programit të tillë.

Trajtim afirmativ i arsimit në gjuhën serbe është edhe në disa ligje tjera në fuqi në Republikën e Kosovës. Këtu duhet të cekim edhe Ligjin për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës²⁰, i cili rregullon organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunitat e Republikës së Kosovës.

Kreu V i Ligjit për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës në mënyrë të veçantë rregullon arsimin në gjuhën serbe. Në nenin 12 (Arsimimi në Gjuhën Serbe) të këtij ligji përcaktohet:

12.1 Komunitat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.

12.2 Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

12.3 Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdoren për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t'i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtoj plane programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret.

12.4 Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjisllacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur.

Po ashtu, në nenin 13 (Komisioni i Pavarur) të Ligjit për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës është përcaktuar themelimi i një Komisioni të pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe, i cili përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- a) tre (3) përfaqësues nga MASHT-i;
- b) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilët që mbajnë ulëset e rezervuara apo garantuara për komunitetin serb të Kosovës; dhe
- c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

13.2 Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash..

²⁰Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 30 / 15 qershor 2008) neni 13 dhe neni 14 i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 25 / 07 shtator 2012)

13.3 Kryesimi i Komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit të zgjedhur nga MASHT-i çdo vit.

Ligj për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës parasheh edhe kompetenca të zgjeruara të Komunës së Mitrovicës Veriore. Në nenin 14 të këtij ligji, kompetencat e poshtëshënuara janë kompetencat komunale për arsimin e lartë në Mitrovicën Veriore:

- a) *Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë;*
- b) *Universiteti miraton statutin që saktëson organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur:*
 - (i) *komisioni i pavarur përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve;*
 - (ii) *tre (3) përfaqësues të përzgjedhur nga MASHT-i;*
 - (iii) *tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga universiteti; dhe*
 - (iv) *një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.*
 - (v) *komisioni i merr vendimet me shumicë votash;*
 - (vi) *kryesimi i komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga Universiteti dhe një përfaqësues i përzgjedhur nga MASHT-i.*
- c) *Vendimet për pajtueshmërinë e statutit me legjislacionin kornizë qendror, standardet dhe praktikat më të mira evropiane si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e universitetit brenda sistemit universitar të Kosovës merren nga komisioni i pavarur i themeluar sipas nenit 14b të këtij ligji;*
- d) *Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencat për këtë universitetin publik në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës;*
- e) *Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy do të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit dhe dy (2) anëtarët tjerë do të zgjidhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit;*
- f) *Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet e tjera institucionale. Fondet për universitetin nga Republika e Serbisë duhet të jenë transparente dhe të bëhen publike, në pajtim me ligjet e Kosovës;*
- g) *Veprimet dhe burimet buxhetore që i ofrohen Universitetit të Mitrovicës Veriore duhet të jenë në pajtim me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në legjislacionin që hyn në fuqi deri më 1 janar 2009; dhe*
- h) *Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.*

Në vargun e ligjeve të cilat i japin trajtim të veçantë afirmativ mësimi në gjuhën serbe është edhe **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale**, i cili shtjellon se: "Komuna e Mitrovicës së Veriut ka

kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimor."²¹

Në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale²², ndër të tjera, në lidhje me kompetencat e zgjeruara të komunave përcaktohet që disa komuna kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore. Gjithashtu, ky ligj përcakton që autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trajnimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve publike. Po ashtu në kuadër të kësaj parashihet që komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Përmbledhje e kornizës ligjore të Republikës së Kosovës:

- Kushtetuta u jep pjesëtarëve të komuniteteve të drejtën që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet. Në mënyrë më të veçantë, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që në mënyrë individuale ose si komunitete të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre.
- Kushtetuta përcakton përgjegjësitë e Shtetit, që sipas nevojës, do të miratoj masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje. Masat e tilla nuk konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.
- Ushtrimi i të drejtave të komuniteteve bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.
- Komunat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe. Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

²¹Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 21 (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr. 28, 4 qershor 2008).

²²Po aty, neni 19.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror(e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e institucionit(-eve)
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702	Institucionet e Kosovës	<p>E drejta për arsimim dhe e drejta për të punuar janë dy nga drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara gjithashtu me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat përmes krijimit të mekanizmave institucional dhe masave përkatëse gjejnë zbatim të drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.</p> <p>Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:</p> <ol style="list-style-type: none"> (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për

			<p>Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;</p> <p>(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;</p> <p>(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.</p>
<p>Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (nenet 23.1 dhe 26.1);</p>	<p>http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf – faqe 3</p>	<p>Institucionet e Kosovës</p>	<p>Secili ka të drejtë të punojë, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kënaqshme dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia. Secili ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në fazat e arsimit fillor dhe themelor. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i përgjithshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në mënyrë të barabartë në bazë të aftësisë.</p>
<p>Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj</p>	<p>http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf – faqe 9</p>	<p>Institucionet e Kosovës</p>	<p>Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të njeriut.</p> <p>Zbatimi i të drejtës për punë dhe të drejtës për arsimim.</p>
<p>Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile</p>	<p>http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf</p>	<p>Institucionet e Kosovës</p>	<p>Qëllimi kryesor i këtij Pakti është se nuk mund të interpretohet asisoj</p>

<p>dhe Politike dhe Protokollat e saj (nenet 5 dhe 25);</p>	<p>on_shqip.pdf – faqe 43</p>		<p>sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt. 2. Nuk lejohet asnjë kufizim ose shmangie nga cilatdo të drejta themelore të njeriut që janë të njohura ose që janë në fuqi në ndonjë shtet palë të këtij Pakti në përputhje me ligjet, konventat, aktet ose zakonet e tjera me pretekstin se ky Pakt nuk i njeh ose i njeh në një shkallë më të vogël. Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë dallim dhe pa kufizim të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.</p>
<p>Konventa Kornizë e Këshillit të</p>	<p>http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konv</p>	<p>Institucionet e Kosovës</p>	<p>Qëllimi kryesor është që Palët do të inkurajojnë një</p>

<p>Evropës për Mbrotjen e Pakicave Kombëtare (nenet 6 dhe 12);</p>	<p>entat%20finale_final%20version_shqip.pdf – faqe 68</p>		<p>frymë tolerance dhe dialogun ndërkulturor dhe do të marrin masa efektive për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë personave që jetojnë në territorin e tyre pa dallim për sa i përket identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar të këtyre personave veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe shtypit. 2. Palët angazhohen të marrin masa të përshtatshme të mbrojnë personat që mund t'i nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, si pasojë e identitetit të tyre etnik, kulturor gjuhësor apo fetar. Palët, kur është e përshtatshme, do të marrin masa në fushën e arsimit dhe studimeve për të nxitur njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare të tyre dhe të shumicës. 2. Në këtë kuadër, Palët do të sigurojnë ndër të tjera mundësi të përshtatshme për kualifikimin e mësuesve dhe pajisjen me tekste shkollore, dhe të lehtësojnë kontaktet ndërmjet studentëve dhe mësuesve të komuniteteve të ndryshme. 3. Palët angazhohen të nxisin mundësi të barabarta për</p>
--	---	--	---

			ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat që i përkasin pakicave kombëtare.
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (nenet 10 dhe 11);	http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813 Konventat%20finale final%20version_shqip.pdf – faqe 89	Institucionet e Kosovës	Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas, me qëllim që t'i sigurohen asaj të drejta të barabarta me burrin në fushën e arsimit, në mënyrë të veçantë, për të siguruar mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e zënies punë, për të siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtat e njëjta
Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (nenet 5 dhe 7);	http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813 Konventat%20finale final%20version_shqip.pdf – faqe 77	Institucionet e Kosovës	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor mbështetet në parimet e dinjitetit dhe të barazisë së të gjithë njerëzve, dhe se të gjitha shtetet anëtare janë zotuar të veprojnë, si bashkërisht ashtu edhe ndaras, në bashkëpunim me Organizatën, për të realizuar një nga objektivat e Kombeve të Bashkuara, që është pikërisht nxitja dhe inkurajimi i respektimit universal dhe real i të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe ose feje,
Konventa për të	http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813 Konventat%20finale final%20version_shqip.pdf	Institucionet e Kosovës	Shtetet Palë njohin të

Drejtat e Fëmijës (nenet 28 dhe 29).	gov.net/747/1/160813 Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf – faqe 101	Kosovës	drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702	Institucionet e Kosovës	<p>Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.</p> <p>Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.</p> <p>1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.</p> <p>3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore</p>
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 09.04.2008		

<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24 (3)</p>			<p>të të tjerëve. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.</p>
<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47</p>			<p>Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.</p> <p>Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.</p>
<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 57 (3, 4).</p>			<p>Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet. 4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e</p>

<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 58 (4)</p>			<p>Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.</p> <p>Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.</p>
<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59</p>			<p>Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, që në mënyrë individuale ose si komunitet të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre; (2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre; (4) të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.</p>
<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 61</p>			<p>Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë</p>

			<p>këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.</p>
<p>Ligji nr. 03/047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 1(1)</p> <p>Ligji nr. 03/047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 8(6)</p> <p>Ligji nr. 03/047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 8(11).</p>	<p>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, 4 qershor 2008.</p> <p>https://gzk.rks.gov.net/LaëInForceList.aspx</p>		<p>1. Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve.</p> <p>“Universiteti i Mitrovicës Veriore është një institucion autonom publik i shkollimit të lartë” dhe i jep Komunës së Mitrovicës Veriore “autoritetin që të ushtrojë përgjegjësi për këtë universitet në gjuhën serbe siç rregullohet me ligj”.</p> <p>Qeveria e Republikës së Kosovës siguron qasje të barabartë të personave që iu përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Në këtë drejtim, Qeveria krijon masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në</p>

			institucionet e arsimit të lartë dhe universitar.
Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 6	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 14, 09.09.2011. https://gzk.rks-gov.net/LaëInForceList.aspx	MASHT	MASHT është përgjegjëse për: Rregullimin e statusit të bartësve publikë dhe privatë të arsimit të lartë dhe miratimin e Statuteve të tyre; Autorizimin, në bashkëpunim me Agjencinë e Akreditimit të Kosovës (AAK), të formatit dhe përmbajtjes së Diplomës dhe Shtojcës së Diplomës të lëshuar nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë, siç përcaktohet me rregulloret e nxjerra nga MASHT; Licencimin e bartësve të arsimit të lartë.
Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 10	(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14, 09 shtator 2011)	Universitetet	Në këtë ligj, 'universiteti' përkufizohet si "një institucion arsimor dhe i kërkimit shkencor, që jep diploma e grada akademike duke përfshirë nivelin e doktoratës, me synim: (a) përparimin në fushën e njohurive akademike, në Kosovë, në rajon dhe më gjerë; (b) zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës; zhvillimin e shkathtësive profesionale dhe të kompetencave të larta; dhe (c) nxitjen e qytetarisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta në mësimdhënie dhe mësimnxënie." Ai përcakton se "emërtimi 'Universitet' mund t'i jepet vetëm atij bartësi të akredituar të arsimit të lartë, që ka ofruar kurse apo programe të

			akredituara për së paku pesë vjet, në të paktën pesë fusha studimi, sikurse përcaktohet në akt nënligjor të Ministrisë dhe i cili ka nxjerrë të paktën nga një të diplomuar me doktoratë të akredituar në secilin nga këto programe studimi."
Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 5(7)	(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14, 09 shtator 2011)	Bartësit e licencuar të arsimit të lartë	Arsimi i lartë mund të ofrohet nga çdo bartës i licencuar i arsimit të lartë, pa kufizim sa i përket kohëzgjatjes apo strukturës së vitit shkollor, me kusht që të mund t'ia dëshmojë në mënyrë të kënaqshme një organi akreditues se diplomat e tij plotësojnë standardet e pritshme për diploma të tilla brenda Zonës evropiane të arsimit të lartë.
Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 21 Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 19	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, 4 qershor 2008)	Institucionet publike dhe komunat me kompetenca të zgjeruara vetanake	Komuna e Mitrovicës së Veriut ka kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimor. Disa komuna, për të cilat jepet shpjegim më poshtë, kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenet që vijojnë. Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e

			<p>kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trajnimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve publike.</p> <p>Komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla.</p>
<p>Ligji nr. 03/068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 14, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës</p>	<p>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, 15 qershor 2008</p>	<p>Institucionet publike dhe komunat me kompetenca të zgjeruara vetanake</p>	<p>Neni 14 i Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës përcakton këto Kompetenca të Zgjeruara të Komunës së Mitrovicës së Veriut në fushën e arsimit të lartë:</p> <p>Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë;</p> <p>Universiteti miraton statutin, që saktëson organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur:</p> <p>Vendimet për pajtueshmërinë e statutit me legjislacionin kornizë qendror, standardet dhe praktikat më të mira evropiane si dhe për</p>

		<p>çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e universitetit Brenda sistemit universitar të Kosovës merren nga komisioni i pavarur i themeluar sipas nenit 14b të Ligjit për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës;</p> <p>Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencat për këtë universitetin publik në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës;</p> <p>Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy do të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit dhe dy (2) anëtarët tjerë do të zgjidhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit;</p> <p>Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet e tjera institucionale. Fondet për universitetin nga Republika e Serbisë duhet të jenë transparente dhe të bëhen publike, në pajtim me ligjet e Kosovës;</p> <p>Veprimet dhe burimet buxhetore që i ofrohen Universitetit të Mitrovicës Veriore duhet të jenë në pajtim me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në legjislacionin që hyn në fuqi deri më 1 janar 2009;</p>
--	--	---

			dhe Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.
Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 30 / 15 qershor 2008) neni 13 dhe Neni 14 i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 25 / 07 shtator 2012)	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, 15 qershor 2008	MASHT Komisioni i pavarur	Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur. Komisioni i Pavarur vendos mbi pajtueshmërinë e Statutit të UMV-së me legjislacionin kornizë të nivelit qendror, dhe me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe çështjet në lidhje me akreditimin e Universitetit në kuadër të sistemit universitar të Kosovës
Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1 dhe 2	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, 26.06.2015	Institucionet qendrore dhe lokale	Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet,

			<p>originës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, originës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.</p> <p>Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:</p> <p>kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet;</p> <p>qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të</p>
--	--	--	---

			avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike; kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës;
Rregullore (QRK)-nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike		Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut Institucionet publike të Republikës së Kosovës	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut (UMV).

Pema e problemit

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij

Efektet	Pamundësia e të diplomuarve në institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe për të realizuar të drejtën për punë në institucionet publike dhe integrimi social i tyre
Problemi kryesor	Diplomat e lëshuara të institucioneve paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, nuk njihen
Shkaqet	Mospërfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës institucionale legjitime të Republikës së Kosovës dhe mungesa e bazës ligjore për njohjen e diplomave të lëshuara nga institucionet paralele

Kapitulli 1.2 Problemi kryesor

Mospërfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës institucionale të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë mungesa e një zgjidhjeje e cila do t’ua mundësonte shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, gjegjësisht Universiteti i Mitrovicës së Veriut, institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, të aplikojnë për punësim dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje tjera për të cilat është e nevojshme paraqet problemin kryesor në këtë çështje. Kjo e vështirëson zbatimin e parimeve të cilat janë të garantuara me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht parimin e trajtimit të barabartë, parimin e të drejtave për arsimim e punësim dhe parimin e mosdiskriminimit.

Kapitulli 1.3 Shkaqet

Gjetja e një zgjidhjeje për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës institucionale të Republikës së Kosovës është e domosdoshme.

E drejta për arsimim duhet të respektohet, mbrohet dhe plotësohet me të gjitha masat ligjore dhe masa të tjera sistematike që i ofron një shtet për të garantuar demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut përmes sistemit të arsimit.

Kapitulli 1.4 Efektet

Që nga përfundimi i luftës (1999) e deri më sot, rrjeti arsimor në gjuhën serbe nuk bashkëpunon me institucionet e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht përdor një sistem tjetër nga ai që përdorin institucionet e Republikës së Kosovës.

Pamundësia e shfrytëzimit të diplomave të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, në vende të punës në administratën publike të Kosovës, por jo vetëm në to, gjithashtu ndërlihet me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi në Kosovë. Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në parimet e mëposhtme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë,

ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.²³

Ligji i Punës ndalon diskriminimin në mënyrë specifike, pasi që aty thuhet se parimet e lartpërmendura zbatohen drejtpërsëdrejti në fushën e punësimit:

“Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi.”²⁴

Për të përfunduar, ofrimi i mundësisë qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët mbajnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, – kryesisht pjesëtarë të komuniteteve joshumicë – për të aplikuar për punësim në institucionet publike të Republikës së Kosovës nuk përbën një çështje politike por një domosdoshmëri që rezulton nga parimet universale të trajtimit të barabartë, të të drejtës për punësim dhe arsimim dhe të mosdiskriminimit. Për të përmirësuar gjendjen aktuale, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrë masa të veçanta afirmative, në përputhje me Kushtetutën.

Dhënia e mundësisë për të aplikuar për punësim, për licencim dhe për dhënie të provimeve profesionale në institucionet publike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, në asnjë rrethanë dhe në asnjë rast nuk duhet të shkelë parimet e meritës, aftësive profesionale, mosdiskriminimit dhe të konkurrencës së hapur. Por kjo mund të bëhet përmes certifikatave të lëshuara sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara paraprakisht, siç është përcaktuar me Rregulloren (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Por, në rastin konkret

²³ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16, 26 qershor 2015, Prishtinë.

²⁴ Ligji i Punës nr. 03/L-212, neni 5(1), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90, 1 dhjetor 2010.

duhet të përfshihen jo vetëm Universiteti i Mitrovicës së Veriut por të gjitha institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe. Shtetasit e Republikës së Kosovës që flasin gjuhën serbe dhe që ndjekin mësimin në gjuhën serbe në institucione paralele janë ata që kanë më së shumti pasoja, dhe përdoren për qëllime politike nga institucionet e Serbisë, duke i inkurajuar dhe financuar që të mos jenë pjesë e sistemit legal shkollor të Republikës së Kosovës. Prandaj, është në dobi të këtyre shtetasve përfshirja e këtyre institucioneve brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.

Figura4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palëve të interesuara	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra në të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - MASHT	MASHT krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë.	MASHT përkrah një sistem arsimor jodiskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve.	MASHT, përmes krijimit të politikave për zhvillimin e arsimit në të gjitha nivelet, përkrah një sistem jodiskriminues arsimor në gjuhën serbe.
Ministria për Komunitete dhe Kthim - MKK	MKK zhvillon politika dhe promovon e zbaton ligje për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimin, punësimin dhe qasjen e barabartë në drejtësi.	MKK siguron se politika në nivel qendror dhe komunal përfshin dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.	Bashkëpunimi në planifikimin dhe koordinimin e politikave që kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, duke u kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të arsimit në gjuhët e komuniteteve.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL	MAPL zhvillon politika dhe zbaton legjislacionin për vetëqeverisje efikase komunale, promovon dhe afirmon të drejtën	Monitorimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit që kanë të bëjnë me komunitetet dhe planifikimin e rregullt për nevojat e	Bashkëpunimi në planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve në nivel lokal.

	<p>e organeve lokale për vetëqeverisje në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, bashkërendon dhe promovon zhvillimin e reformës së pushtetit lokal, bashkërendon dhe përkrah bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar, kontribuon në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga organet e vetëqeverisjes lokale si kryen edhe detyra të tjera.</p> <p>Komuna e Mitrovicës së Veriut</p> <p>Komunat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe. Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas</p>	<p>komuniteteve në nivel komunal.</p> <p>Komuna e Mitrovicës së Veriut do të sigurojë që UMV të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burime të tjera institucionale. Përveç burimeve të financimit që janë në dispozicion të bartësve të tjerë publikë të arsimit të lartë, fondet për UMV-në që jepen nga Republika e Serbisë duhet të jenë</p>	<p>Komuna e Mitrovicës së Veriut është e autorizuar për licencimin UMV-së (LVL, neni 21), në mbështetje të dispozitave të LAL dhe dokumenteve shtesë të nxjerra në bazë të tij. Kriteret specifike për dhënien e licencës UMV-së duhet të jenë të njëjta me kriteret për dhënien e licencës një universiteti tjetër publik dhe kjo duhet të inkorporohet në Statutin e UMV-së. Kjo kompetencë e zgjeruar e Komunës së Mitrovicës së Veriut monitorohet nga MASHT-i (LVL, neni 19(2)).</p>
--	--	--	---

	<p>njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.</p> <p>Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdoren për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t'i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtojë plane programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret. 12.4 Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të LAK-së, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për</p>	<p>transparente dhe të bëhen publike, në përputhje me ligjet e Kosovës (LAK, neni 14).</p>	
--	--	--	--

	mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur (LAK, Neni 12).		
Zyra për Çështje të Komuniteteve - ZÇK	ZÇK vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe informon dhe këshillon me kohë dhe në mënyrë të duhur Kryeministrin për të gjitha çështjet e ndërlidhura me komunitetet. ZÇK koordinon dhe monitoron të gjitha çështjet e lidhura me komunitetet, përfshirë institucionet, donatorët organizatat ndërkombëtare, për të siguruar që çështjet e komuniteteve janë marrë parasysh në mënyrë të efektshme në tërë Kosovën, dhe për të siguruar eliminimin e përsëritjes së përpjekjeve dhe sigurimin e barazisë në ndarjen e fondeve dhe shfrytëzimin efektiv të tyre.	ZÇK lajmëron Kryeministrin për çështje të rëndësishme me interesit lokal, nacional, rajonal dhe ndërkombëtar; ZÇK mban marrëdhënie të mira dhe koordinim me të gjitha palët e përfshira, posaçërisht me MKK-në, MAPL-në, KKK-në, KDIKK-në, ZQM-në dhe Institucionin e Avokatit të Popullit.	ZÇK këshillon dhe promovon zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përshtatshme për komunitetet nga ana e qeverisë. Po ashtu, ZÇK rekomandon ndryshime dhe/ose rregullon ligjet dhe politikat relevante për komunitetet, nëse ato nuk janë duke i adresuar çështjet e komuniteteve në mënyrë efektive.
ECMI Kosova	ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin		ECMI Kosova ka zhvilluar hulumtimin: "Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë" në kuadër të projektit "Mbështetje për arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë: procesi i verifikimit të diplomave të UMV-së, hulumtim mbi gjendjen aktuale, zhvillimi i një udhërrëfyese të MASHT-it dhe përkrahja e drejtpërdrejtë për UMV dhe stafin e tij mësimdhënës, i cili ka qenë një bazament i mirë i të dhënave për Ekipin gjatë përgatitjes së këtij koncept

	dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.		dokumenti.
Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut	<p>Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut është përgjegjës për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Republikës e Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.</p> <p>Komisioni mandatin e tij e ushtron në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike.</p>		<p>Certifikatat e lëshuara në përputhje me këtë rregullore konfirmojnë vlefshmërinë e diplomave universitare të UVM-së për qëllim të aplikimit për punësim në institucionet publike, për marrjen e licencave profesionale të lëshuara nga institucionet publike si dhe për pjesëmarrje në provimet profesionale të organizuara nga institucionet publike.</p> <p>Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut është përgjegjës për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Republikës e Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.</p>
Këshilli Konsultativ për Komunitete	Këshilli Konsultativ për Komunitete vepron	Mandati i Këshillit Konsultativ për	Këshilli Konsultativ për Komunitete,

	<p>nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.</p> <p>Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve.</p>	<p>Komunitete përfshin:</p> <p>(1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;</p> <p>(2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;</p> <p>(3) çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.</p>	<p>në përputhje me Ligjin nr. 03/L-047</p> <p>për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, ka për mandat:</p> <p>a) të ndihmojë në organizimin dhe artikulin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;</p> <p>b) të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim midis komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, në përputhje me kodin e mirësjelljes që do të miratohet nga Këshilli Konsultativ për Komunitete;</p> <p>c) të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore;</p> <p>d) t'ua ofrojë mundësinë komuniteteve që në faza të hershme të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave të cilat mund të përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi, të sugjerojnë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të inkorporohet në projekte dhe programe përkatëse, përfshirë strategjinë dhe raportin vjetor;</p> <p>e) të plotësojë kërkesën për konsultime tjera të detyrueshme në relacion me akte të caktuara ligjore që janë paraparë në Kushtetutë dhe ligj;</p> <p>f) t'ua mundësojë komuniteteve që të marrin</p>
--	--	---	--

			<p>pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;</p> <p>g) të japë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare apo të ndara nga buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave të tyre të veçanta;</p> <p>h) të kontribuojë në raportimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut; dhe</p> <p>i) të ngritë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe t'u kontribuojë marrëdhënieve harmonike midis të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.</p>
UP/UMV	<p>Universiteti i Mitrovicës së Veriut është institucion publik autonom i arsimit të lartë, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, i ndryshuar me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 25 / 07 shtator 2012) dhe nenin 21 të</p>		

	Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 / 4 qershor 2008)		
Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)	Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.	Në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.	Çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të autoriteteve, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.
Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, përkatësisht Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe nga institucionet tjera arsimore para universitare dhe universitare, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe			

Kapitulli 1.5 Përafrimi me standardet ndërkombëtare dhe të drejtën e BE-së

E drejta për arsimim dhe e drejta për të punuar janë dy nga drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara gjithashtu me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare²⁵, të cilat janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.²⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut garanton, përveç të tjerash, se: *“secili ka të drejtë të punojë, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kënaqshme dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia”* dhe se *“arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i përgjithshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet t’u bëhet i mundshëm të gjithëve në mënyrë të barabartë në bazë të aftësisë”*.²⁷

Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare si Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë dhe imponojnë tri lloje apo nivele të detyrimeve të Republikës së Kosovës, përkatësisht: të respektojë, mbrojë dhe përmbushë secilën nga këto të drejta dhe liri të garantuara me ligj. Detyrimi për t’i respektuar kërkon nga shtetet palë që të shmangin masa që pengojnë ose parandalojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Obligimi për të mbrojtur u kërkon Shteteve palë që të marrin masa që parandalojnë palët e treta nga ndërhyrjet që pengojnë gëzimin e së drejtës për punësim dhe arsimim.²⁸

E drejta për arsimim duhet të respektohet, mbrohet dhe plotësohet me të gjitha masat ligjore dhe masa të tjera sistematike që i ofron një shtet për të garantuar demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut përmes sistemit të arsimit. Këto strategji janë reflektuar në organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit, si dhe në mekanizmat e zbatimit. Disa tregues themelorë për analizimin e zbatimit të së drejtës në arsimim nga shtetet janë si në vijim:

²⁵ Këto përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (nenet 23.1 dhe 26.1); Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj (nenet 5 dhe 25); Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (nenet 6 dhe 12); Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (nenet 10 dhe 11); Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (nenet 5 dhe 7); Konventën për të Drejtat e Fëmijës (nenet 28 dhe 29).

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 dhe neni 53;

²⁷ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nenet 23.1 dhe 26.1;

²⁸ Zbatimi i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 13 (Seanca e 21-të, 1999).

- Prania e një kornize ligjore që garanton disponueshmërinë dhe qasjen në arsim për të gjithë popullsinë;
- Disponueshmëria dhe qasja aktuale në arsim për pjesëtarët e grupeve të ndryshme brenda popullatës së shtetit (në bazë të moshës, gjinisë, kombësisë/etnisë, sfondit social);
- Niveli i decentralizimit në menaxhimin e institucioneve arsimore dhe në procesin e vendimmarrjes;
- Diversiteti dhe mobiliteti i sistemit arsimor;
- Ekzistimi i arsimit formal dhe joformal;
- Autonomia e personelit mësimdhënës (kuadrit arsimor);
- Financimi i arsimit;
- Zhvillimi dhe cilësia e sistemit arsimor (kushtet materiale, shtrirja gjeografike e institucioneve arsimore, personeli/kuadri, programet e studimit).
- Zbatimi i së drejtës për punë, si një standard i të drejtave të njeriut, shkon përtej mbrojtjes dhe sigurimit të punësimit si një mjet i mbijetesës apo mirëqenies materiale, por gjithashtu përfshin kultivimin e marrëdhënieve të barazisë dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Treguesit në këtë drejtim përbëjnë jo vetëm mungesën e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procedurat e aplikimit por edhe mungesën e përpjekjeve që një shtet ka marrë për të garantuar qasjen në punësim për të gjitha grupet e popullsisë së përgjithshme të shtetit dhe përfaqësimin e barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në sektorin publik dhe atë privat. Megjithatë, duhet të merret parasysh se mbrojtja dhe plotësimi i të drejtës për punësim nuk duhet të shkelë parimet e meritës, aftësive profesionale, mosdiskriminimit dhe të konkurrencës së hapur. Kjo nuk duhet në asnjë mënyrë të çojë në punësimin e personave që i takojnë grupeve të mbrojtura në kundërshtim me procedurat e përgjithshme, duke reduktuar kështu kërkesat minimale për punësim në institucionet publike.
- Mosdiskriminimi.

Kapitulli 2: Objektivat

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë

diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim dhe integrim social.

2.1. Objektivat strategjike

- Promovimi i parimit të trajtimit të barabartë, i parimit të të drejtave për arsimim e punësim dhe i parimit të mosdiskriminimit.

2.2. Objektivat specifike

- Njohja e diplomave të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, deri në vitin 2022.
- Përfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Promovimi i parimit të trajtimit të barabartë, i parimit të të drejtave për arsimim e punësim dhe i parimit të mosdiskriminimit;	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Zyra e Kryeministrit, Objektivi 2 “Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës”
Njohja e diplomave të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, deri në vitin 2022.	Sipas këtij koncept dokumenti
Përfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.	Sipas këtij koncept dokumenti dhe strategjisë gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës

Kapitulli 3: Opsionet

Tri janë opsionet që duhet të ndërmerren lidhur me mësimin në gjuhën serbe në Kosovë:

- 3.1. Opsioni i status quo-së;
- 3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe
- 3.3. Opsioni për zgjidhjen e gjendjes.

Kapitulli 3.1: Opsioni i status quo-së/opsioni pa ndryshime

Përmes prezantimit të gjendjes ekzistuese dhe masave të cilat duhet të ndërmerren për avancimin e zhvillimit të mësimi në gjuhën serbe në Kosovë vihet në pah edhe një herë se mbajtja e **status quo-së** në lidhje me institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe shkakton moszbatim të kornizës ligjore ekzistuese të Kosovës. Njëherazi, zbatimi i këtij opsioni pengon edhe punësimin e personave të diplomuar në institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe dhe si rrjedhojë kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë, parimin e të drejtave për punësim dhe arsimim dhe parimin e mosdiskriminimit, që janë të mishëruara në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit

Ekipi ka konsideruar opsionin për përmirësimin e zbatimit të kornizës aktuale ligjore, por ka arritur në përfundim se problemi në mënyrë strikte konsiston në çështje ligjore, siç janë mandati i Komisionit dhe përfshirja e të diplomuarve nga sistemi parauniversitar dhe universitar, që në përputhje me parimin e ligjshmërisë duhet të parashihen me akte ligjore.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë për zgjidhjen e gjendjes

Opsioni për përmirësimin e zbatimit synon plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhej përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në të gjitha institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe. Lëshimi i certifikatave dhe përdorimi i tyre si zëvendësim i diplomave të lëshuara nga institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe do të ishte masë e përkohshme afirmative për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim dhe integrim social. Kjo masë afirmative do të aplikohet deri në vitin 2022.

Njëkohësisht, hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve dhe masave konkrete për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së

Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit publik. Zbatimi i këtij opsioni mund të bëhet me një gjithëpërfshirje të akterëve përkatës si dhe me një proces të konsultimeve publike, që do t'i ndihmonte edhe politikëbërësit në gjetjen e një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore, por që ka edhe implikime politike.

Janë një varg shembujsh në Evropë ku zhvillohet mësimi në gjuhët e ndryshme të komuniteteve dhe që mund të merren parasysh edhe për arsimin në gjuhën serbe në Republikën e Kosovës gjatë hartimit të strategjisë gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe. Këtu vlen të përmenden modelet e Tirolit Jugor, modeli gjermano-danez, modeli i arsimit hungarez në Rumani. Të gjitha këto modele do të analizohen gjatë përgatitjes së strategjisë. Megjithatë, këtu vlen të përmendim disa segmente të modelit gjermano-danez që mund të jenë interesante për zbatim në sistemin e arsimit në Kosovë dhe një udhëzues praktik i mirë në procesin e hartimit të strategjisë gjithëpërfshirëse. Shkollat daneze janë shkolla të cilat janë të harmonizuara me sistemin shkollor gjerman dhe nën juridiksionin gjerman. Gjatë hartimit të strategjisë mund të merren parasysh edhe çështjet që përfshijnë por nuk kufizohen në menaxhimin e shkollës, financimin dhe absorbimin e shpenzimeve, procedurat e rekrutimit, zgjedhjet; bordet e shkollave; dhe alokimin e burimeve. Po ashtu, janë me interes përvojat nga modeli gjermano-danez lidhur me zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore, me një fokus të veçantë në lëndët e ndjeshmërisë politike të tilla si letërsia dhe historia. Gjithashtu, do të diskutohet gjuha e mësimdhënies për secilën lëndë, në mënyrë që të kuptohet si të promovohet dygjuhësia. Sipas këtij modeli, sa i përket lëshimit i diplomës, diplomat e lëshuara nga shkollat daneze në rajonin gjerman njihen automatikisht nga të dyja vendet. Provimet përfundimtare pas klasës së 9-të (diploma e shkollës së mesme) merren nga të gjithë nxënësit në Danimarkë në të njëjtën ditë dhe janë provime të sakta në të gjithë vendin. Megjithatë, për studentët e shkollave të minoriteteve gjermane u krijua një alternativë e dytë duke u dhënë atyre mundësinë që të marrin një provim shtesë në gjermanisht. Ky provim vlerësohet nga Ministria Gjermane e Arsimit në Schlesëig-Holstein. Gjendja është si më poshtë; nëse ata kanë kaluar provimet e tyre përfundimtare daneze dhe një shtesë gjermane, diploma e tyre daneze do të njihet edhe në gjuhën gjermane. Ata pastaj janë në gjendje të aplikojnë për universitetet në të dy vendet pa ndonjë test të gjuhës tjetër.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve në të drejtat themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësishëm të ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuar për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara për OP 1	Ndikimet përkatëse të identifikuara për OP 2	Ndikimet përkatëse të identifikuara për OP 3
Ndikimet ekonomike	Do të vijë deri të përkeqësimi i gjendjes aktuale, si stagnim i zhvillimit ekonomik, zvogëlim i vendeve të punës.	Do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik. Do të rritet numri aktual i mundësive të punësimit.	Do të ketë ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik. Do të rritet edhe më shumë numri aktual i vendeve të punës.
Ndikimet shoqërore	Do të ketë stagnim në procesin e zhvillimit të të gjitha kategorive të ndikimeve shoqërore.	Do të rritet numri aktual i mundësive të punësimit, gjë që do të ndikojë në rritjen e mirëqenies sociale. Do të ndikojë në zbatimin e parimeve të trajtimit të barabartë në shoqëri.	Do të rritet edhe më shumë numri aktual i vendeve të punës, gjë që do të ndikojë në rritjen e mirëqenies sociale. Do të ndikojë në gjithëpërfshirje dhe në zbatimin e parimeve të trajtimit të barabartë në shoqëri.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.
Ndikimet në të drejtat themelore	Do të vijë deri të përkeqësimi i zbatimit të trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të individëve dhe në respektimin e të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
Ndikimi gjinor	Nuk janë identifikuar ndikime relevante.	Rritja e numrit të grave të punësuar dhe të arsimuara.	Rritja e numrit të grave të punësuar dhe të arsimuara.
Ndikimet e barazisë sociale	Do të vijë deri të përkeqësimi i zbatimit të trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,

	dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.	të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.	të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
Ndikimet tek të rinjtë	Të rinjtë e diplomuar në institucionet paralele ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, në pamundësi të punësimit në institucionet e Republikës së Kosovës, do të detyrohen të largohen nga Kosova.	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.	Do të ketë ndikim në zbatimin e trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.
Ndikimi në NMV-të	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.	Nuk ka ndonjë ndikim relevant.

Kapitulli 4.1: Sfidat në mbledhjen e të dhënave

Nga të gjitha palët pranohet fakti që ekziston një mungesë e theksuar e të dhënave për arsimimin në gjuhën serbe që zhvillohet në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë, në mungesë të të dhënave, Ekipi, gjatë punës së tij, ka marrë parasysh Raportin e Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova): Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë.²⁹ Ky raport është finalizuar gjatë vitit 2018, dhe Ekipi ka shfrytëzuar të dhënat nga ky raport, që në vazhdimësi do t’i referohemi si “Raporti i ECMI Kosova”.

Siç shihet edhe në Raportin e ECMI Kosova, të dhënat e mbledhura janë heterogjene dhe zbulojnë shumëllojshmëri të konsiderueshme kur krahasojmë katër komunat në veriun e Kosovës (Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Zveçanit, Komuna e Leposaviqit dhe Komuna e Zubin Potokut) me zonat me shumicë serbe të shpërndara në pjesën tjetër të Kosovës (komunat: Klllokot, Ranillug, Partesh, Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë).


Shkollat në katër komunat veriore kanë kushte më të mira pune dhe pajisje më të mira sesa shkollat në pjesën tjetër të Kosovës. Në këtë vlerësim theksohen shqetësimet serioze në lidhje me

²⁹Shih: Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë.

mangësitë infrastrukturore dhe mungesën e hapësirës. Në pjesën jugore të vendit shkollat janë të vendosura në ndërtesa që nuk janë të destinuara për këtë qëllim. Shqetësimet më të mëdha janë për kushtet higjienike dhe mungesën e tualeteve brenda objekteve, sidomos në shkollat që ndodhen në rajonin e Gorës.³⁰

Duke iu referuar Raportit të ECMI Kosova, “Shkollat që ofrojnë arsimim në gjuhën serbe gjenden në gjashtë rajone të Kosovës: Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren (pra, në të gjitha rajonet përveç Gjakovës). Po sipas këtij raporti, vlerësohet se mësimin në shkollat në gjuhën serbe, ku përfshihen 69 shkolla fillore dhe 34 të mesme, e vijnë rreth 17.456 nxënës.³¹

Shumica e shkollave që ofrojnë arsimim në gjuhën serbe në Kosovë janë shkolla fillore (69). Rajoni me numrin më të madh të shkollave në gjuhën serbe është Mitrovica, me 34 shkolla në këtë gjuhë – 16 prej tyre në qytetin e Mitrovicës; ndërsa me pas vjen Prishtina (29) dhe Gjilani (22). Mbulimi më i madh është në pjesën veriore dhe atë lindore të vendit, ku jetojnë më së shumti pjesëtarët të komunitetit serb. Ekzistojnë 34 shkolla të mesme dhe shumica e tyre gjenden në komunat kryesore me shumicë serbe: Mitrovicë, Leposaviq, Shtërpcë dhe Graçanicë. Katër shkolla të mesme në rajonin e Pejës (Gorazhdevc) dhe atë të Prizrenit (Dragash) përbëjnë përjashtim nga kjo.³²



30 Shih: Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë.


31 Shih Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë.

32 Shih f. 11, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë.

Në shumicën e rasteve ofrohet transport për në shkollë, sidomos për nxënësit të cilët duhet të udhëtojnë më shumë se 3-4 km.³³

Paralelet e ndara përbëjnë një fenomen shumë të zakonshëm në sistemin arsimor që zhvillohet në gjuhën serbe në Republikën e Kosovës.

Numri i tërësishëm i paraleleve të ndara në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë është 141. Ndërtesat amë të këtyre paraleleve gjenden në qendrat e komunave, por për të lehtësuar qasjen në arsim për nxënësit që banojnë më larg nga qendrat, këto struktura të ndara, që zakonisht mbulojnë klasat 1–4, gjenden në fshatra të vogla. Paralelet e ndara janë të shpërndara kryesisht në rajonet jugore, ku pjesëtarë të komunitetit serb janë më të izoluar nga qendrat e komunave. Rastet më të rëndësishme të kësaj kategorie janë: shkolla fillore në fshatin Gorazhdevc, me 12 klasa të ndara; në Shtërpcë rreth 327 nxënës ndjekin mësimin në 12 klasa të zhvendosura si paralele të ndara; në rajonin e Gjilanit përafërsisht një mijë nxënës ndjekin mësimin në klasa të vendosura jashtë ndërtesave amë. Pothuajse të gjitha paralelet e ndara gjenden në hapësira publike.³⁴




Siç shihet në diagramin e mësipërm: balanca gjinore është relativisht e barabartë edhe nëse përjashtojmë shkollat teknike, në të cilat ka më shumë nxënës se nxënëse. Në shkollën e mesme elektroteknike “Milladin Popoviq” në Graçanicë mësimin e ndjekin gjithsej 138 nxënës dhe vetëm 4 nxënëse. Në shkollën e mesme ekonomike dhe të turizmit në fshatin Mlikë, në rajonin e Gorës, përqindja e nxënësve në raport me nxënëset është 3 me 1. Në Mitrovicë, Instituti Teknik

³³ Shih f. 11 dhe 12, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë: Megjithatë, cilësia e transportit në përgjithësi është shumë e dobët.

³⁴ Shih f. 12, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë:

dhe shkolla teknike “Mihajlo Petroviq Allas” numëron vetëm 25 nxënës nga gjithsej 278 nxënës të të dy gjinive. Nga ana tjetër, shumica e nxënësve në shkollat mjekësore janë zakonisht të gjinisë femërore. Rast që e ilustron këtë është ai i shkollës së mjekësisë me konvikt për nxënës në Mitrovicë, ku mësimin e ndjekin 367 nxënës dhe 16 nxënës.³⁵



Diagrami i tretë me shirita tregon numrin e nxënësve të përkatësive etnive joserbe që ndjekin shkollimin në gjuhën serbe në Kosovë. Sipas pyetësorëve, vetëm një nxënës shqiptar ndjek mësimin në gjuhën serbe, gjegjësisht në shkollën fillore “Veljko Dugosheviq” në Ranillug. Në veçanti bie në sy minoriteti rom në shkollat në gjuhën serbe, me gjithsej rreth 831³⁶ nxënës në nivelin fillor dhe 83 në atë të mesëm, të përqendruar kryesisht në komunat e Gjilanit, Graçanicës, Mitrovicës, Kamenicës dhe Vushtrrisë. Duhet përmendur dy shkolla në Graçanicë dhe në Mitrovicë për numrin e madh të fëmijëve romë. Në shkollën fillore “Milladin Mitiq” në Graçanicë janë të regjistruar 111 nxënës romë, nga gjithsej 456 sa ka shkolla. Në shkollën “Dositej Obradoviq” në Mitrovicë mësimin e ndjekin vetëm disa nxënës romë (85), si dhe në dy shkollat fillore “Predrag dhe Miodrag Mihajloviq” dhe “Desanka Maksimoviq” të cilat nuk kanë ofruar të dhëna mbi numrin e nxënësve. Nxënës të komunitetit goran ndjekin mësimin në pesë shkolla në rajonin e Gorës, me gjithsej 593 nxënës. Goranët gjithashtu ndjekin mësimin në gjuhën serbe në rajonin e Mitrovicës. Edhe një numër i konsiderueshëm i nxënësve boshnjakë, gjithsej 77, ndjekin mësimin në gjuhën serbe në rajonin e Mitrovicës. Në shkollën fillore “Sveti Sava” mësimin e ndjekin 22 nxënës boshnjakë, prej gjithsej 817 nxënësve. Arsytet pse nxënësit nga komuniteti boshnjak zgjedhin të ndjekin shkollimin në gjuhën serbe, e jo në shkollat në gjuhën boshnjake, janë kulturore dhe gjeografike. Në disa raste ata nuk kanë mundësi të tjera,

³⁵ Siç u përmend në diagram, disa të dhëna nuk mund të kategorizohen sipas gjinisë, pasi që 4 shkolla nuk kanë ofruar të dhëna mbi gjininë e nxënësve (shkollat teknike “Dragi Popoviq” në Gjilan, “Dimitrije Prica” në Prishtinë, “Nikolla Tesla” në Leposaviq dhe shkolla fillore “Milun Jakshiq” në Skenderaj.

³⁶ Dy shkolla fillore në Mitrovicë (“Predrag dhe Miodrag Mihajloviq” dhe “Desanka Maksimoviq”) në të cilat mësimin e ndjekin vetëm nxënës romë nuk kanë ofruar informata mbi numrin e nxënësve.

pasi që shkollat në gjuhën boshnjake janë shumë larg. Krejt në fund, një numër shumë i vogël i përfaqësuesve të grupeve të tjera etnike ndjekin mësimin në shkollat e Kosovës në gjuhën serbe, kryesisht në Mitrovicë dhe në Graçanicë. Në këtë studim është vënë re në veçanti rasti i tre kroatëve, një malazezit, një turkut dhe një çekut. Në komunën e Lipjanit, ku graviton fshati Janjevë, ku jetojnë shumica e kroatëve, në shkollën “Vlladimir Nazor” mësimin e ndjekin 24 nxënës të komunitetit kroat.³⁷

Rënia e numrit të nxënësve përbën një problem të konsiderueshëm për shkollat në gjuhën serbe. Mesatarja evropiane për numrin e nxënësve për një mësimdhënës/profesor është 14:1 për shkollat fillore dhe 12:1 për shkollat e mesme. Të dhënat për shkollat në gjuhën serbe në Kosovë tregojnë se ky proporcion është qartazi nën mesataren evropiane. Gjysma e shkollave fillore dhe 72% e shkollave të mesme kanë mesatarisht më pak se 5 nxënës për një mësimdhënës/profesor. Shpjegimi qëndron në numrin e madh të paraleleve të ndara nga objektet kryesore, të cilat kanë personelin e tyre mësimdhënës, por shpesh pak nxënës. Përveç kësaj, numri i mësimdhënësve/profesorëve nuk varet nga numri i përgjithshëm i nxënësve, por nga lëndët që mësohen. Prandaj, edhe nëse një klasë ka pak nxënës, numri i mësimdhënësve/profesorëve varet nga numri i lëndëve që japin.³⁸

Madhësia mesatare e klasave korrespondon me kapacitetin e shkollës. Për shkollat ku mësimin e ndjekin nga më pak se 50 nxënës, klasat kanë shumë pak nxënës – 3 deri në 7 fëmijë. Në shkollat me mbi 50 nxënës klasat përbëhen nga 7 deri në 15 nxënës. Në rastin e instituteve më të mëdha, me mbi 250 nxënës, klasat përbëhen nga rreth 25–30 nxënës. Numri më i vogël i nxënësve për një mësimdhënës/profesor është regjistruar në rajonet Ferizaj, Pejë dhe Gjilan, ku nuk është e pazakontë të gjesh shkolla fillore me mesatarisht më pak se një nxënës për një pjesëtar të personelit mësimdhënës.

³⁷ Shih f. 14, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë: Në rajonin e Pejës dhe atë të Gorës vjen në pah mungesa e nxënësve. Arsyeja kryesore është emigrimi ose zhvendosja në komunat me shumicë serbe. Në këto rajone shkollat janë të shpërndara nëpër fshatra të largëta dhe në to mësimin e ndjekin vetëm nga disa fëmijë. Këto shkolla përballen me rrezik serioz të mbylljes, për shkak të mungesës së nxënësve dhe burimeve financiare. Ngjashëm, në disa shkolla në Gjilan mësimin e ndjekin nga më pak se 20 fëmijë. Ky është rasti me dy shkolla fillore: “Branko Radiçeviq” dhe “9 Maji”, në Kamenicë. Megjithëse infrastruktura e të dy këtyre shkollave është në kushte shumë të këqija, sfida kryesore e përmendur nga të intervistuarit është mungesa e nxënësve. Pasoja kryesore e një numri të vogël të fëmijëve të regjistruar është e ardhmja e pasigurt për këto shkolla, të cilat rrezikojnë të mbyllen.

³⁸ Shih f. 14, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë: Në rajonin e Pejës dhe atë të Gorës vjen në pah mungesa e nxënësve. Arsyeja kryesore është emigrimi ose zhvendosja në komunat me shumicë serbe. Në këto rajone shkollat janë të shpërndara nëpër fshatra të largëta dhe në to mësimin e ndjekin vetëm disa fëmijë. Këto shkolla përballen me rrezik serioz të mbylljes për shkak të mungesës së nxënësve dhe burimeve financiare. Ngjashëm, në disa shkolla në Gjilan mësimin e ndjekin më pak se 20 fëmijë. Ky është rasti me dy shkollat fillore “Branko Radiçeviq” dhe “9 Maji” në Kamenicë. Megjithëse infrastruktura e të dy këtyre shkollave është në kushte shumë të këqija, sfida kryesore e përmendur nga të intervistuarit është mungesa e nxënësve. Pasoja kryesore e një numri të vogël të fëmijëve të regjistruar është e ardhmja e pasigurt për këto shkolla, të cilat rrezikojnë të mbyllen. Siç dëshmohet nga kjo anketë, rënia e numrit të nxënësve përbën një problem të konsiderueshëm për shkollat në gjuhën serbe.

Sa i përket gjatësisë mesatare të ditës së shkollës, nuk ka raste të veçanta për t’u theksuar. Në përgjithësi, kohëzgjatja mesatare e një dite shkollë është mes 4 dhe 6 orësh për të gjitha shkollat në gjuhën serbe në Kosovë. Shumë shkolla e organizojnë mësimin në ndërrime të mëngjesit dhe të pasdites, për shkak të mungesës së hapësirës. Në disa raste, shkollat duhet t’ia dalin me deri në tre ndërrime në ditë, veçanërisht në rajonet në pjesën jugore.

Shkollat speciale për nxënës me nevoja të veçanta sa i përket të mësuarit gjenden në Mitrovicë, Leposaviq dhe Graçanicë. Shkolla “Kosovski Bozhur” në Mitrovicë numëron 46 nxënës me nevoja të veçanta. Shkolla në Leposaviq ka 30 nxënës me nevoja të veçanta. Në Graçanicë, nxënësit me nevoja të veçanta ndjekin mësimin në shkollën “Kralj Millutin” dhe atë “Knez Lllazar”, me nga 5 nxënës në secilën prej tyre.³⁹

Një problem me të cilin përballen shkollat në gjuhën serbe në Kosovë është se shumë prej tyre shfrytëzojnë objekte që nuk janë ndërtuar të destinuara për arsim ose që janë në nevojë urgjente për rinovim dhe investime. Ka edhe raste kur e njëjta shkollë, kryesisht shkollë fillore, shfrytëzohet edhe për nivele tjera, shkollë të mesme apo edhe fakultete. Për shembull, shkolla e mesme për mekanikë të automjeteve në Graçanicë është në ndërtesën e shkollës fillore “Kralj Millutin”. Për pasojë, kjo shkollë fillore nuk ka hapësirë të mjaftueshme për 684 nxënësit e saj dhe mësimi duhet të organizohet me ndërrime. Rasti më alarmant është raportuar në Mitrovicë, ku katër shkolla dhe dy fakultete duhet të ndajnë të njëjtin objekt. Një rast i ngjashëm është ai i gjimnazit në Shillovë, i cili është zhvendosur nga Gjilani, i shkollës së lartë elektroteknike dhe Fakultetit të Mjekësisë, të cilat janë zhvendosur nga Prishtina në Graçanicë, dhe i shkollës ekonomike dhe të turizmit, e cila është zhvendosur nga Dragashi në objektin e shkollës fillore në fshatin Mlikë.⁴⁰

Gjithashtu, duhet të theksohet që ekziston një mungesë e theksuar e të dhënave për arsimimin në gjuhën serbe në shkollat e larta që zhvillohet në Republikën e Kosovës, por në parim statistikat e përgjithshme të përafërta janë si në vijim:

Shkolla e lartë në Zvecan i ka 40 studentë;

Shkolla e lartë e trafikut në Leposavic i ka 500 studentë;

Shkolla e lartë ekonomike e Pejës në Leposaviq i ka 2500 studentë.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i këtyre konsultimeve është arritur në konkluzionin se është e nevojshme që të bëhet

³⁹ Shih f. 16, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë:

⁴⁰ Shih f. 17, Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Prishtinë:

plotësim/ndryshimi i kornizës ligjore ekzistuese. Përmes takimeve të ndryshme, janë zhvilluar konsultimet me ekspertë dhe njohës të kësaj fushe, si dhe duke përfshirë përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit (Sekretariatit Koordinues të Qeverisë që e ka udhëhequr gjithë procesin, Zyrës Ligjore, Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Kabinetit të Kryeministrit), Zyrës së Presidentit, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Komunës së Ranillugut, ECMI Kosova etj., të cilët kanë shprehur pikëpamjet dhe kontributin e tyre për rregullimin e kësaj fushe. ECMI Kosova gjatë gjithë procesit të hartimit, konsultimit dhe finalizimit të këtij koncept dokumenti ka dhënë mbështetjen dhe ekspertizën e vazhdueshme.

Rekomandimi i përgjithshëm i gjithë procesit konsultues është që të bëhet ndryshimi i politikës ekzistuese. Gjatë gjithë kohës së hartimit të këtij dokumenti, palët e interesuara janë informuar për qëllimet e takimeve, si dhe për zhvillimet që kanë ndodhur pas takimeve. Me qëllim të prezantimit të draftit të koncept dokumentit, në fund të muajit shtator 2018 është organizuar një punëtori, ku pjesëmarrës ishin anëtarët e Ekipit dhe përfaqësues nga institucionet e ndryshme. Gjatë këtij takimi, të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan me dokumentin e prezantuar, si dhe pati disa propozime të reja, të cilat janë adresuar.

Gjithashtu, me plan të komunikimit janë paraparë aktivitetet që do t'i ndërmarrim edhe pas miratimit të këtij draft koncept dokumenti.

Në pajtim me Rregulloren 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, procesi i konsultimeve publike është bërë përmes metodave të ndryshme, përfshirë platformën elektronike për konsultimet publike dhe takimet e drejtpërdrejta me palë të interesuara, ku i është dhënë mundësia institucioneve dhe kategorive të shoqërisë, qoftë atyre me ndikim ose interes të lartë apo atyre që mund të japin kontributin e tyre për shqyrtimin e opsioneve. Kontribut të rëndësishëm mund të japin të gjitha kategoritë e shoqërisë, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe ekspertët e projekteve të ndryshme të asistencës teknike në institucionet e Republikës së Kosovës.

Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon nxitjen dhe sigurimin e një procesi të konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjitha palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara dhe të ndikuara nga projekt	Takim publik	Komunikimi dhe njoftimi bëhet përmes platformës online për konsultime publike me palët e	Dokumenti është publikuar në platformë nga data	Kosto administrative	Komunikimi realizohet përmes zyrtarit përgjegjës për projekt

	propozimi		interesuara	20 mars deri më datë 10 prill		propozimin, siç parashihet në Rregulloren 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik
Konsultimi paraprak	Konsultim i brendshëm tek institucionet relevante	Konsultim me shkrim	Njoftimi është bërë përmes e-mail	Afati kohor për dhënien e opinioneve nga data 21 shkurt deri më 13 mars të vitit 2019	Kosto administrative	
Konsultimi i akterëve të jashtëm	Organizatata tjera që punojnë në këtë fushë	Konsultim me shkrim dhe përmes platformës	Njoftimi përmes e-mail dhe platformës.		Kosto administrative	
Punëtori	Ekipi për hartimin e KD-së, ECMI, përfaqësues nga komunat	Hartimi i KD-së	Njoftimi është bërë përmes e-mailit zyrtar	Punëtorja e parë 20-23 shtator 2018, punëtorja e dytë 13-17 mars 2019	Punëtoritë janë mbështetur nga ECMI	

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Tri janë opsionet që duhet të ndërmerren për avancimin e zhvillimit të mësimi në gjuhën serbe në Kosovë:

1. Opsioni i status quo-së;
2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit;
3. Opsioni për zgjidhjen e gjendjes.

Opsioni i parë pengon punësimin e personave të diplomuar në institucionet paralele në Republikën e Kosovës. Opsioni i dytë bën një zgjidhje të përkohshme dhe jogjithëpërfshirëse, deri në gjetjen e një zgjidhje të përhershme, ndërsa opsioni i tretë parasheh masa për gjetjen e një zgjidhje të përhershme. Duke marrë parasysh kontekstin ligjor dhe politik në Republikën e Kosovës, rekomandohet që si hap i parë të ndërmerret Opsioni i tretë dhe njëkohësisht të fillohet me plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 si dhe në përgatitjen për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.

Tabela e krahasimit me të tri opsionet:

Metoda e krahasimit:			
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3: Zgjidhja e gjendjes
Ndikimet relevante pozitive	Nuk ka	Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhej përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në të gjitha institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.	Përmes plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhej përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave jo vetëm për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut por edhe për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare si dhe hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij opsioni mund të bëhet krahas zbatimit të opsionit të dytë dhe të bëhet me një gjithëpërfshirje të akterëve përkatës si dhe me një proces të konsultimeve publike që do t'i ndihmonte edhe politikëbërësit në gjetjen e një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore, por që ka edhe

										implikime politike, ku mund të përfshihet edhe procesi i dialogut.
Ndikimet relevante negative	Mbajtja e <i>status quo</i> -së në lidhje me institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe shkakton moszbatim të kornizës ligjore ekzistuese të Kosovës. Njëherazi, zbatimi i këtij opsioni pengon edhe punësimin e personave të diplomuar në institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe dhe si rrjedhojë kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë, parimin e të drejtave për punësim dhe arsimim dhe parimin e mosdiskriminimit, që janë të mishëruara në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës.			Nuk ka			Nuk ka			Nuk ka
Kostot relevante	Nuk ka përfitime			Ofron përfitime më të mëdha pa kosto shtesë			Ofron përfitime më të mëdha pa kosto shtesë			
	Nuk ka kosto shtesë			Nuk ka kosto shtesë			Nuk ka kosto shtesë			
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	
Përfundimi	Nuk ka përfitime			Ofron përfitime më të mëdha pa kosto shtesë			Ofron përfitime më të mëdha pa kosto shtesë			

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Opsioni nr. 2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit

Plani i zbatimit për Opsionin 2 nuk është elaboruar.

Opsioni nr. 3: Opsioni për zgjidhjen e gjendjes

Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 me të cilën do të bëhet përcaktimi i procedurave dhe kritereve për lëshimin e certifikatave jo vetëm për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut por edhe për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në institucionet tjera arsimore parauniversitare dhe universitare si dhe hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës. Ky është opsioni i propozuar nga Ekipi dhe zbatimi i këtij opsioni mund të bëhet me një gjithëpërfshirje të akterëve përkatës si dhe me një proces të konsultimeve publike, që do t'i ndihmonte edhe politikëbërësit në gjetjen e një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore, por që ka edhe implikime politike.

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin nr. 3

Qëllimi i politikës	Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit publik.							Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Promovimi i parimit të trajtimit të barabartë, i parimit të të drejtave për arsimim e punësim dhe i parimit të mosdiskriminimit;							
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1	Produkti							
Njohja e diplomave të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, deri në vitin 2022.	Rregullorja (QRK) - nr. 21/2015 e plotësuar dhe ndryshuar	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
	Aktiviteti 1.1.: Hartimi i plotësim ndryshimit të Rregullores nr. 21/2015	x					ZL/ZKM	
	Aktiviteti 1.2.: Konsultimi i plotësim ndryshimit të Rregullores nr. 21/2015	x					ZL/ZKM	

		Aktiviteti 1.3.: Miratimi i Rregullores nr. 21/2015 të plotësuar dhe të ndryshuar	X						Qeveria	
		Aktiviteti 1.4: Promovimi i mundësive të parapara sipas plotësim ndryshimit të Rregullores	x	x					Komisioni për Verifikimin e Diplomave (në bashkëpunim me ECMI)	
		Aktiviteti 1.5: Shqyrtimi i aplikacioneve dhe lëshimi i certifikatave të vlefshmërisë	x	x	x	x			Komisioni për Verifikimin e Diplomave	
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		Institucioni /departamenti përgjegjës	
Objektivi Specifik 2 Përfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës	Produkti Strategjia gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës	Aktiviteti 2.1. Hartimi i strategjisë		X	x				MASHT, në bashkëpunim me Komisionin dhe ZKM-në	

	së Kosovës.								
		Aktiviteti 2.2. Konsultimi i strategjisë			x				
		Aktiviteti 2.3. Miratimi i strategjisë				X		Qeveria	
		Aktiviteti 2.4. Ndërmarrja e veprimeve specifike që rrjedhin nga strategjia				X	x		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Si opson më i favorshëm për rekomandim konsiderohet të jetë opsioni i tretë, Opsioni për përmirësimin e zbatimit, i cili synon plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike si dhe hartimin e strategjisë gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 do të bëhej përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në të gjitha institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe. Lëshimi i certifikatave dhe përdorimi i tyre si zëvendësim i diplomave të lëshuara nga institucionet paralele në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe do të ishte masë e përkohshme afirmative për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim dhe integrim social, ndërsa me strategjinë do të gjendej një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore për përfshirjen e mësimi në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, gjithnjë duke marrë parasysh standardet dhe praktikën më të mira evropiane për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

Figura 9: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar: Opsioni nr. 2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit

Qëllimi i politikës	Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të shtetasve të Republikës së Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit publik.							Shifra e kostos së pritur		
Objektivi strategjik	Promovimi i parimit të trajtimit të barabartë, i parimit të të drejtave për arsimim e punësim dhe i parimit të mosdiskriminimit;									
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës									
Objektivi Specifik 1 Njohja e diplomave të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe, deri në vitin 2022.	Produkti Rregullorja (QRK) - nr. 21/2015 e plotësuar dhe e ndryshuar		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës		
		Aktiviteti 1.1.: Hartimi i plotësim ndryshimit të Rregullores nr. 21/2015	x						ZL/ZKM	
		Aktiviteti 1.2.: Konsultimi i plotësim ndryshimit të Rregullores nr. 21/2015	x						ZL/ZKM	
		Aktiviteti 1.3.: Miratimi i Rregullores nr. 21/2015 të plotësuar dhe të ndryshuar	X						Qeveria	
		Aktiviteti 1.4: Promovimi i mundësive	x	x					Komisioni për Verifikimin e Diplomave	

		të parapara sipas plotësimit ndryshimit të Rregullores						(në bashkëpunim me ECMI)	
		Aktiviteti 1.5: Shqyrtimi i aplikacioneve dhe lëshimi i certifikatave të vlefshmërisë	x	x	x	x		Komisioni për Verifikimin e Diplomave	
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Objektivi Specifik 2 Përfshirja e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës	Produkti Strategjia gjithëpërfshirëse për përfshirjen e arsimit në gjuhën serbe brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.	Aktiviteti 2.1. Hartimi i strategjisë		X	x			MASHT, në bashkëpunim me Komisionin dhe ZKM-në	
		Aktiviteti 2.2. Konsultimi i strategjisë			x				
		Aktiviteti 2.3. Miratimi i strategjisë				X		Qeveria	
		Aktiviteti 2.4.				X	x		

		Ndërmarrja e veprimeve specifike që rrjedhin nga strategjia							
--	--	---	--	--	--	--	--	--	--

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

MASHT, në bashkëpunim me Komisionin për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe institucionet tjera përgjegjëse të nivelit qendror dhe lokal, do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores (QRK) - nr. 21/2015. Pas miratimit të tij dhe kalimit të afatit të paraparë do të zhvillohet një proces i monitorimit dhe vlerësimin të ndikimit të këtij akti nënligjor, në mënyrë që të bëhet vlerësimi se a i ka arritur qëllimet dhe pritshmëritë e tij plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (QRK) - nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike.

Shtojca nr. 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ⁴¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		+			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		+			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		+			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	+		I lartë	I lartë	I lartë
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		+			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		+			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		+			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		+			
	A do të krijohen biznese të reja?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		+			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		+			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		+			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		+			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e		+			

⁴¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?					
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		+			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	+		I ulët	I ulët	I ulët
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		+			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		+			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		+			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		+			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		+			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		+			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		+			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		+			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		+			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		+			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		+			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		+			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe		+			

Koncept Dokumenti: "Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe"

	shërbimeve ekzistuese?					
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? (shih listën e ndarjes se profesioneve...)		+			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar? (ZP, MV, L...)		+			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	+		I ulët	I ulët	I ulët
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		+			

Shtojca nr. 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ⁴²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		+			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		+			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		+			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		+			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	+		I lartë	I LARTË	I lartë
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta? (10 komunitat)		+			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	+		I lartë	I lartë	I lartë
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		+			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		+			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		+			
	A do të ketë ndikim në financimin apo		+			

⁴² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?					
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		+			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	+		I lartë	I lartë	I lartë
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	+				
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?	+				
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?	+				
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?	+				
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?	+				
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	+		I ulët	I ulët	I ulët
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		+			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		+			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		+			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		+			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?	+		I ulët	I ulët	i ulët

Shëndeti dhe siguria publike ⁴³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		+			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		+			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		+			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		+			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		+			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		+			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		+			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		+			
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		+			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		+			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		+			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	+		I lartë	I lartë	I lartë
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		+			

⁴³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

Shtojca nr. 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		+			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		+			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		+			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		+			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		+			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		+			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		+			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		+			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		+			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		+			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		+			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		+			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		+			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në		+			

	shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?					
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		+			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		+			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		+			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		+			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		+			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		+			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		+			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		+			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		+			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		+			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		+			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		+			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		+			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		+			

Koncept Dokumenti: *“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”*

Shtojca nr. 4: Forma e vlerësimit për ndikimin në të drejtat themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	+		I lartë	I lartë	I lartë
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	+		I lartë	I lartë	I lartë
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		+			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		+			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		+			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		+			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		+			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	+		I ulët	I ulët	I ulët
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		+			
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		+			
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		+			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		+			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm

	biznes?					
Trajtimi i barabartë ⁴⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		+			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		+			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		+			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		+			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		+			
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		+			
	A ndikohet qasja në drejtësi?	+		I mesëm	I mesëm	I mesëm

⁴⁴ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*